



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA E APELIT PRISHTINË

Numri i lëndës: 2023:095891
Datë: 23.04.2024
Numri i dokumentit: 05606882

PAKR.nr.54/2024

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS, Departamenti i Krimeve të Rënda - kolegji i përbërë nga gjyqtarët: Kadrije Goga Lubishtani kryetare e kolegjit, Vatton Durguti dhe Skender Çoçaj - anëtarë, me pjesëmarrjen e bashkëpunëtores profesionale Gresë Latifi, në çështjen penale ndaj të akuzuarit Sh.B., për shkak të veprës penale: Blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitja e paautorizuar e narkotikëve, substancave psikotrope dhe analoge, nga neni 267 par.2 lidhur me nenin 31 të KPRK-së, duke vendosur përkritazi me ankesën e Prokurorisë Themelore në Mitrovicë – Departamenti i Krimeve të Rënda, të ushtruar kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Mitrovicë, Departamenti i Krimeve të Rënda, PKR.nr.129/2023 i datës 27.11.2023, në seancën e kolegjit të mbajtur konform dispozitës së nenit 390 të KPPK-së, me datë 03.04.2024, mori këtë:

A K T G J Y K I M

REFUZOHET si e pabazuar ankesa e Prokurorisë Themelore Mitrovicë – Departamenti i Krimeve të Rënda, ndërsa aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Mitrovicë- Departamenti i Krimeve të Rënda, PKR.nr.129/2023 i datës 27.11.2023, **VËRTETOHET**.

A r s y e t i m

Gjykatës Themelore në Mitrovicë - Departamenti i Krimeve të Rënda, me aktgjykimin PKR.nr.129/2023 i datës 27.11.2023, konform nenit 363 par.1 nënpar.1.3 të KPP-së e ka liruar nga akuza të akuzuarin SH.B. për shkak të veprës penale Blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitja e paautorizuar e narkotikëve, substancave psikotrope dhe analoge, nga neni 267 par.2 lidhur me nenin 31 të KPRK-së, pasi që nuk ka provat që i akuzuari ka kryer veprën penale për të cilën është ngarkuar me aktakuzë nga PTH në Mitrovicë- Departamenti i Krimeve të Rënda.

Ne mbështetje të nenit 276 të KPP-së e lidhur me nenin 267 par.5 të KPRK-së, në mënyrë të përhershme është urdhëruar të konfiskohet sasia e narkotikut e llojit marihuanë në sasi prej 344.67 ± 0001 gram, dy peshore digjitale, një mulli, të cilat pasi që aktgjykimi të merr formën e prerë do të shkatërrohen nga Policia e Kosovës.

Në pajtim me dispozitën e nenit 116 të KPP-së:

Është URDHËRUAR – që pas plotfuqishmërisë së aktgjykimit, të bëhet kthimi i veturës e markës “Golf V”, ngjyrë hiri metalike, me targa, çelësat, libreza dhe një telefon Iphone 7, ngjyrë e zezë, në pronësi të pandehurit Sh.B.

Shpenzimet e procedurës penale bien në barrë të mjeteve buxhetore të gjykatës. Palë të dëmtuar nuk kishte.

Kundër këtij aktgjykimi në afatin ligjor ankesë ka ushtruar:

Prokuroria Themelore në Mitrovicë – Departamenti i Krimeve të Rënda, për shkak të vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike nga neni 386 të KPPK-së me propozim që Gjykata e Apelit të Kosovës aktgjykimin e ankimuar ta anuloj dhe lëndën t’ia kthej të njëjtës gjykatë në shqyrtim dhe vendosje të serishme.

Përgjigje në ankesë ka paraqitur mbrojtësi i të akuzuarit Sh.B., av.S.B., duke propozuar që Gjykata e Apelit të refuzoj si të pabazuar ankesën e ushtruar nga Prokuroria Themelore në Mitrovicë.

Prokuroria e Apelit me parashtresën, PPA/I.nr.69/2024, datë 31.01.2024 ka propozuar që të aprovohet ankesa e Prokurorisë Themelore në Mitrovicë ashtu që aktgjykimi i ankimuar të anulohet dhe çështja ti kthehet gjykatës së shkallës së parë në rigjykim dhe rivendosje kurse përgjigja në ankesë e mbrojtësit të akuzuarit Sh.B., av.S.B., të refuzohet si e pa bazuar.

Gjykata e Apelit caktoj dhe e mbajti seancën e kolegjit në pajtim me dispozitën e nenit 390 të KPRK-së, në të cilën kanë prezantuar i akuzuari Sh.B., mbrojtësi i të akuzuarit av.S.B., ndërsa nuk ka prezantuar askush nga Prokuroria e Apelit, edhe pse të njoftuar me rregull për ditën dhe kohën e mbajtjes së seancës.

Gjykata e Apelit e Kosovës shqyrtoi shkresat e lëndës, gjithashtu vlerësoi aktgjykimin e kundërshtuar në kuptim të nenit 394 të KPP-së, dhe pas vlerësimit të pretendimeve në ankesa gjeti se: **Ankesa nuk është e bazuar.**

Pretendimet ankimore të Prokurorisë

Në ankesë Prokuroria Themelore në Mitrovicë – Departamenti për Krime të Rënda thekson se arsyet e aktgjykimit ankimor, janë të paqarta dhe kontradiktore me vetveten, me provat dhe dokumentet disponuese në shkresat e lëndës. Gjykata e shkallës së parë cek se pas vlerësimit të provave: të dëshmitarit B.U., administrimit të provave materiale si: raportet policore si ai i datës 26.04.2023 dhe ato të datës 24.04.2023, vërtetimit mbi sekuestrimin e përkohshëm të sendeve të dt.24.04.2023 lidhur me sekuestrimin e telefonit, procesverbalit të kontrollit dhe sekuestrimit të sendeve të dt.24.04.2023, ekspertizës AKF/2023-1393/23-1290 të dt.30.05.2023, foto dokumentacionit, nuk ka arritur të vërtetoj se i akuzuari SH.B. ka kryer veprën penale për të cilën akuzohet sipas aktakuzës. Prokuroria tutje shton se në këtë kontest gjykata aktgjykimin ankimor e ka bazuar në vlerësimin e gabuar të provave të administruara, ashtu që ekziston kundërthënie e konsiderueshme në mes të përmbajtjes së provave dhe atyre të cekura në arsyetim të aktakuzës. Në arsyetimin e aktgjykimit, gjykata për vërtetimin e fakteve vendimtare është bazuar në dëshmitë e të pandehurit SH.B. dhënë në shqyrtim gjyqësor. Gjykata fare nuk ka marr për bazë me rastin e nxjerrjes së këtij aktgjykimi provat e prokurorisë si: dëshminë e të pandehurit F.Z. dhënë në polici dhe në prokurori, raportet policore, vërtetimet mbi sekuestrimin e përkohshëm të sendeve të dt.24.04.2023, procesverbalin për kontroll dhe sekuestrim të përkohshëm të dt.24.04.2023, deklaratën e dëshmitarit, raportin e ekspertimit të Agjencisë së Kosovës për forenzikë AKF/2023-1393/23-1290 të dt.30.05.2023, foto-dokumentacion, informacionin mbi të

kaluarën kriminale në emër të pandehurit, gjykata këto dëshmi si më lartë, të arsyetuara edhe në aktakuzë PP.I.nr.81/2023 fare nuk i mori për bazë. Se i pandehuri SH.B. ka kryer veprën penale me të cilën është ngarkuar me aktakuzë vërtetohet nga raporti i policit hetues i dt.24.04.2023, nga vërtetimet mbi sekuestrimin e përkohshëm të sendeve të dt.24.04.2023, nga raporti i njësisë së DHTN-së gjatë punës hetimore, nga dëshmia e dëshmitarit B.U., nga deklarata e të pandehurit F.Z. në prokurori, nga deklarata e të akuzuarit SH.B. e dhënë në prokurori, poashtu nga raporti i ekspertimit nga Agjencia e Kosovës për forenzikë AKF/2023-1393/23-1290 i dt.30.05.2023, nga foto dokumentacioni që gjendet në shkresat e lëndës e po ashtu edhe nga informacionet mbi të kaluarën kriminale për të pandehurin SH.B. shihet se i njëjti është i njohur për 65 vepra penale të ndryshme, gjithashtu ka edhe katër urdhër arreste aktive, dy prej tyre për substanca narkotike. Të gjitha këtyre dëshmive si më lartë gjykata nuk ia fali besimin, me arsyetim se me asnjërin nga provat si më lartë nuk provohet fakti se me veprimet e ndërmarra nga i pandehuri janë përmbushur elementet e veprës penale. Sipas Prokurorisë nga të lartcekurat, rrjedh dyshimi i bazuar mirë se i akuzuari SH.B. ka kryer veprën penale Blerja, posedimi, shpërndarja, dhe shitja e paautorizuar e narkotikeve, substancave psikotrope dhe analoge nga neni 267 par. 1 të KPRK-së. Në rastin konkret gjykata nuk ka bërë krahasimin adekuat të provave dhe nuk i ka trajtuar ato në tërësinë e tyre. Gjkata në asnjë moment nuk ka krahasuar të gjitha provat e deponuara në Gjykatë nga ana e Prokurorisë, prova këto që Gjykata nuk ua ka dhënë besimin. Sikurse gjykata të kishte marrë për bazë edhe provat e propozuara – shqyrtuara të prokurorisë me siguri do të kishte nxjerrë një vendim krejtësisht tjetër, andaj edhe ka propozuar si më lartë.

Gjetjet e Gjykatës së Apelit

Edhe pse aktgjykimi i ankimuar i gjykatës së shkallës së parë nuk ankimohet për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale nga neni 384 të KPP-së, megjithatë kjo Gjykatë të njëjtin e shqyrtoi sipas detyrës zyrtare, konform nenit 394 par.1 të KPPK-së, dhe gjeti se aktgjykimi i ankimuar nuk përmban shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale ngase dispozitivi i aktgjykimi është i qartë dhe në përputhshmëri të plotë me arsyetimin e tij, ku janë dhënë arsyet e duhura mbi të gjitha faktet vendimtare të kësaj çështje penale-juridike, duke vepruar kështu konform dispozitës të nenit 369 par.6 dhe 10 të KPPK-së, ku gjykata e shkallës së parë ka paraqitur arsyet për çdo pikë të aktgjykimit të ankimuar.

Gjykata e shkallës së parë, ka bërë analizën e të gjitha provave të proceduara gjatë shqyrtimit gjyqësor dhe më pas ka bërë vlerësimin e provave në pajtim me dispozitat e nenit 360 par.1 dhe 2 të KPPK-së, kështu që në rastin konkret gjykata e shkallës së parë ka dhënë arsye të qarta dhe të mjaftueshme në kuptim të nenit 363 par.1 nënpar.1.3 të KPP-së, duke ardhur në përfundim se nga provat e administruara në shqyrtim gjyqësor nuk është provuar se i akuzuari ka kryer veprën penale për të cilën akuzohet pra, gjykata e shkallës së parë ka bërë analizën dhe vlerësimin e të gjitha provave të procedura gjatë shqyrtimit gjyqësor dhe lidhur me të njëjtat ka paraqitur konkludimet e veta, të cilat si të drejta objektive dhe të ligjshme i aprovon edhe kjo gjykatë.

Sa i përket pretendimeve ankimore përkitazi me vërtetimin e gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, Gjykata e Apelit e Kosovës gjen se këto pretendime janë të pabazuara ngase gjykata e shkallës së parë edhe gjendjen faktike në këtë çështje penale e ka vërtetuar në mënyrë të drejtë dhe të plotë, pasi që nga provat e administruara në shqyrtim gjyqësor nuk janë vërtetuar faktet dhe rrethanat e pretenduara si në aktakuzë për kryerjen e veprës penale Blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitja e paautorizuar e narkotikëve, substancave psikotrope dhe analoge, nga neni 267 par.2 lidhur me nenin 31 të KPRK-së nga i akuzuari Sh.B., për të cilën vepër penale gjykata e shkallës së parë edhe e ka liruar nga akuza bazuar në dispozitën e nenit 363 par.1 nënpar.1.3 të KPP-së. Kjo, pasi që Gjykata e shkallës së parë për vërtetimin e gjendjes faktike në këtë çështje penale ka ardhur pas administrimit të provave personale dhe atyre materiale.

Kështu, ka dëgjuar dëshminë e dëshmitarit, B.U., të dhënë në shqyrtim gjyqësor, i cili ka deklaruar se, e kam njohur F.Z. sepse ka qenë së pari shok i vëllait, pastaj edhe shok i imi, dhe se ai Golfi ka qenë i imi tjetër nuk kam, e kam fjalën Golfin të cilin e kanë sekuestruar policia unë ia kam jep një natë më parë F.Z. i cili më ka kërkuar me arsyetimin se ka me dal me një femër dhe i kam thënë se nesër më vyn automjeti sepse ka me shku për analiza të nënës. Unë nuk e kam ditur se ai është përdorues i substancave narkotike. Unë jam përdorues sepse 11 vite kam jetuar në Holandë, gruan dhe fëmijët i kam atje mu mi kanë prish letrat dhe jam kthyer në Kosovë dhe jam duke e pritur bashkimin familjar, atje e kam përdor sepse atje është i lejuar përdorimi i substancave. Unë kam qenë në burg, por në pavijon tjetër ndërsa ai në pavion tjetër. Unë nuk e njoh personin Sh.B., kur F. ka ardhur me marrë kerrin ka qenë vetëm. Ndërsa, në deklaratën e dhënë në polici ka dëshmuar se, me datën 23.04.2023 rreth orës 21:00 personi F.Z. me të cilin njihemi si shokë më ka shkruar në telefon dhe më ka kërkuar veturën time të tipit Golf 4 me arsyetimin se dua të dal me një femër për çka kam edhe dëshmi shkrimin në telefon. Unë i thash se po mundem me ta dhënë veturën pa llogaritur që F. mund ta keqpërdor besimin tim, rreth orës

24 ka ardhur dhe e ka marrë veturën time dhe deri sot kur më ka thirr policia se duhet të lajmërohem në polici në V. Në veturë kam pasur dokumentet e automjetit dhe pasaportën time. Deklaroj me përgjegjësi të plotë se nga ora 24 e datës 23.04.2023 unë nuk e kam parë e as takuar F.Z.

Ndërsa nga provat materiale ka administruar: Raportin informues policor i dt.24.04.2023, nga i cili vërtetohet fakti se me dt. 24.04.2023 rreth orës 9:50 min, një patrullë e policisë që kanë qenë duke lëvizur në fshatin D., Komuna e V., ku kanë vërejtur një veturë Golf 5 me targa ... e ndalur në afërsi të malit dhe kanë vërejtur dy persona në të. Posa është ndalur vetura e policisë mbrapa veturës së dyshuar nga ana e pasagjerit ka dalë një person me një kavanoz të qelqit në dorë dhe ka ikur me vrap në drejtim të pyllit, policët iu kanë vënë në ndjekje duke i dhënë urdhra verbal, i dyshuari në një moment e ka lëshuar në tokë kavanozin me substancë narkotike dhe ka ikur nëpër pyll. Policia ka qenë në ndjekje dhe nuk ka arritur ta arrestoj. Personi që ka qenë në ulësen e shoferit është F.Z. i cili është arrestuar dhe në veturë në ulësen e parë janë gjetur gjashtë qese me substancë të dyshuar narkotike e llojit marihuan, dy telefona mobil dhe një pasaportë në emër të B.U. Pasi janë fotografuar dhe janë evidentuar dëshmitë rreth orës 13:35 min, kemi përfunduar me bastisje. Më pas kemi shkuar në fshatin B. tek shtëpia e personit B.U., pasaporta e të cilit ka qenë në veturë nën dyshimin se ka qenë ai personi që ka ikur nga vetura, por shtëpia ishte e mbyllur, nuk ishte askush brenda më vonë u lajmërua në polici B.U. i cili ka deklaruar se mbrëmë ja ka dhënë veturën personit F.Z. dhe se vetura është e tij dhe në veturë ka pasur pasaportën. Dy personat dhe vetura janë sjellë në zyrat e DHTN-së në Mitrovicë për procedura të mëtejme.

I dyshuari Fatos Zenuni në deklaratën e dhënë në prani të avokatit mbrojtës, të caktuar sipas detyrës zyrtare, ka deklaruar se mbrëmë ka marrë veturën nga personi B.U. dhe se sot ka qenë në veturë kur i ka ndal policia me personin SH.B. dhe ai person ka ikur nga policia.

Pastaj, janë evidentuar dëshmitë e sekuestruara, vetura Golf V, me targa ... , dokumentet dhe qelës i thyer i veturës pronë e B.U., një telefon mobil IPHONE pronë e F.Z., një telefon mobil IPHONE, pronë e Sh.B., 6 paketime substancë të dyshuar narkotike e llojit marihun me peshën 5.9 gram e gjetur në veturën Golf, një kavanoz i qelqit me substancë të dyshuar narkotike e llojit marihuan me peshë 353.7 gram (personi që ka ikur nga vetura e ka hedhur në tokë gjatë ikjes), një mulli që shërben për bluarjen e marihuanës i gjetur nga bastisja në banesën e F.Z., një peshore digjitale e gjetur në banesën e F.Z., një peshore digjitale e gjetur në shtëpinë e të dyshuarit F.Z.

në fshatin M., substancë e dyshuar narkotike, marihuan në peshë 18 gram e gjetur e shpërndarë në një dhomë mbi një tavolinë e dy në dysheme në shtëpinë e të dyshuarit F.Z. në fshatin M.

Nga raporti tjetër policor i dt.24.04.2023, përshkruhet e njëjta mënyrë e ngjarjes me shtesën se personi tjetër nga ai që ka ikur i cili ishte në ulësen e vozitësit - policët kanë arritur ta kapin dhe të njëjtin ta prangosin, personi i arrestuar kishte me veti letërnjoftimin i cili ishte F.Z., në automjet tek këmbët ku ishte ulur personi i cili ka ikur ishte një telefon dhe pasaporta ku dyshohet se është pasaporta e të njëjtit person i cili ka ikur dhe ai është B.U. Personi i cili ishte prangosur në automjet, nga dera tjetër e automjetit ka dalur me qëllim për të ikur mirëpo i njëjti jo larg automjetit në mal është kapur, i njëjti është ankuar se ka përdorur substancë të tepruar narkotike dhe nuk ndihet mirë, është dërguar në emergjencë në V.

Nga ekspertiza AKF/2023-1393/23-1290 dt.30.05.2023, është konstatuar se sipas karakteristikave morfologjike dhe përbërjes kimike dëshmitë #1.1, 1.2, 1.3, 1.4, 1.5, 1.6, 2 dhe 3 përbëjnë kanabis (marihuana) që përmban Tetrahidrokanabinol (THC), pesha neto e përgjithshme 344.67=001 gram. Nga foto dokumentacioni prej 22 fotove shihet vendi i ngjarjes, kavanozi me substancë narkotike, vetura, substancë narkotike e gjetur. Vërtetimi mbi sekuestrimin ku vërtetohen sendet e sekuestruara.

I akuzuari SH.B. në shqyrtimin gjyqësor të mbajtur me datë 20.11.2023, është deklaruar se ditën kritike nuk e di ku kam qenë, me F.Z. kam shkruar, ka qenë shok i burgut, ditën kritike nuk jam takuar me të njëjtin dhe nuk jemi takuar asnjëherë që nga koha kur kemi qenë në burg, kohëve të fundit nuk kam qenë në V., nuk kemi askënd në V., kam qenë përdorues i narkotikëve, por që dy vite jam në rehabilitim për çka kam dokumentacion. Në pyetjet e prokurorisë i njëjti ka deklaruar se në M. e ka të martuar një çik të vëllaut por asnjëherë nuk kam bujt te kjo, nuk kam qenë në V. me datën 24.04.2023, as në M. Me F.Z. nuk jam taku, kemi shkru me sms, njihem si kryes i veprave penale të rrahjes ndërsa asnjëherë për vepër penale të narkotikëve. I akuzuari me datën 31.05.2023 në prokurori në M. kishte shfrytëzuar të drejtën për tu mbrojtur në heshtje.

I pandehuri F.Z. – tani i ndjerë, në deklaratën e tij të dhënë në Prokurori me dt. 07.06.2023 kishte deklaruar: ditën kritike në mëngjes jam zgjuar dhe kam dal në qytet në V. me veturën e shokut tim B.U. –veturë Golf V. Deri sa isha në qytet me automjet duke u shëtir në telefon më ka thirrur SH.B. dhe më tha “a je anej se po vij pak me të pa” unë i thashë se jam nëpër V. ai erdhi pas 20-30 min në V. në një rrugë pas kafiqave që nuk e di si quhet. Ai hipi në automjet dhe më tha:

“hajde shkojmë në fshatin tënd M., pasi që unë jam në arrati”. Faktikisht Sh. edhe më herët ka qëndru në V. në një banesë të cilën e ka pasur me qera. Ne u nisëm për në M., Sh. gjatë rrugës e nxorri një kavanoz /tegull/ dhe e pashë që është marihuanë, ai kavanozën e nxorri nga një qese të cilën e ka pasur në dorë kur ka hipur në automjetin tim. Këtë kavanoz Sh. e vendosi para këmbëve të tij dhe aty e ka mbajtur deri sa kemi shkuar në fshatin M. Gjatë rrugës më ka pyetur se “a mundem ta lë këtë kavanoz në shtëpinë tënde në fshatin M.” unë i thashë jo në shtëpi nuk mund ta lëmë se çka të bëhet mund të jetë përgjegjësia ime por këtë mundemi me fshehur diku në fshat”. Me automjet kemi shkuar tek pylli që është larg shtëpisë diku 1-2 km aty e kemi ndalur automjetin ku më tha se “do ta marrim nga pak bari për ta konsumuar së bashku”, aty Sh. e di se i ka mbushur diku 5-6 qese me narkotikë prej të cilave më ka thënë se “dy ti jepi ty”. Në këto momente deri sa Sh. ka qenë duke i mbushur këto qese me narkotikë ka arrit policia dhe menjëherë Sh. njëherë ka bërtit “policia” pastaj e ka marrë kavanozin dhe nuk e di as vet se si ka ikë, mirëpo duke ikur nga policia Sh. e ka hedhur kavanozin. I pandehuri shton se B.U. e kam shok, veturën ia kam marrë një ditë para rastit, automjetin ia kam marrë për të dal me një vajzë. B. nuk e ka ditur se unë merrem me narkotikë. As nuk e kam paramenduar se do të vij Sh. me narkotikë e as që do të takohem me të. Narkotikun e kam blerë në M. për ta konsumuar vet dhe atë herën e fundit i kam blerë 25-26 gram, sepse jam konsumues i narkotikëve. I pandehuri shton se fillimisht unë nuk kam dasht që ta identifikoj Sh. sepse e kam shok dhe më dhimbset më vonë gjatë bashkëpunimit me policinë kam treguar, këtë veprim e kam bërë gjatë komunikimit me policinë ku ata më kanë thënë “pse po e merr barrën mbi veti për veprimet e dikujt tjetër” atëherë unë e kam pranuar dhe kam treguar.

Nga këto provat e administruara, gjykata e shkallës së parë, pasi që i ka analizuar dhe vlerësuar, në veçanti deklarata e F.Z., si i bashkëpandehur në të njëjtin rast, ka ardhur në përfundim se mbi bazën e kësaj dëshmi nuk mund të shpall fajtor të akuzuarin, si provë e vetme për të identifikuar të akuzuarin Sh.B., ndërsa në anën tjetër duke u mbështetur në dispozitën e nenit 257 par.1 të KPP-së, përkitazi me raportet e policisë i cili raport ishte mbështetur plotësisht në deklarinimin e të bashkëpandehurit F.Z., ku i pandehuri apo mbrojtësit të tij nuk kanë mund të kundërshtojnë të njëjtën në ndonjë fazë të procedurës, ka ardhur në përfundim se nga provat tjera të kësaj çështje penale nuk është vërtetuar se i akuzuari ka kryer veprën penale për të cilën është akuzuar nga prokuroria, për të cilën përfundim të gjykatës së shkallës së parë, për arsyet e sipër cekur, pajtohet edhe kjo Gjykatë, si përfundim të drejtë dhe ligjor. Andaj, kolegji penal i kësaj Gjykate vlerëson që pretendimet e prokurorisë në këtë drejtim janë të pabazuara dhe si të tillë nuk qëndrojnë ngase

nga provat si në shkresat e kësaj lënde nuk vërtetojnë përtej dyshimit të bazuar mirë se i akuzuari Sh.B., ka kryer veprën penale për të cilën është ngarkuar me aktakuzën e PTH në M.

Përkitazi me pretendimet e prokurorisë se, gjykata e shkallës së parë aktgjykimin ankimor e ka bazuar në vlerësimin e gabuar të provave të administruara, ashtu që ekziston kundërthënie e konsiderueshme në mes të përmbajtjes së provave dhe atyre të cekura në arsyetim të aktakuzës, ngase në arsyetimin e aktgjykimit gjykata për vërtetimin e fakteve vendimtare është bazuar në dëshmitë e të pandehurit SH.B. dhënë në shqyrtim gjyqësor ndërsa fare nuk ka marr për bazë me rastin e nxjerrjes së këtij aktgjykimi provat e prokurorisë si: dëshminë e të pandehurit F.Z. dhënë në polici dhe në prokurori, raportet policore, vërtetimet mbi sekuestrimin e përkohshëm të sendeve të dt.24.04.2023, procesverbalin për kontroll dhe sekuestrim të përkohshëm të dt.24.04.2023, deklaratën e dëshmitarit, raportin e ekspertimit të Agjencisë së Kosovës për forenzikë AKF/2023-1393/23-1290 të dt.30.05.2023, foto-dokumentacion, informacionin mbi të kaluarën kriminale në emër të pandehurit, këto pretendime nuk qëndrojnë dhe si të tillë janë të pabazuara pasi që gjykata e shkallës së parë këto provat i kishte analizuar dhe vlerësuar e për të cilat kishte dhënë arsyet konkrete dhe të qarta si në arsyetimin e aktgjykimit të ankimuar e nga të cilat provat ka ardhur në përfundim se nuk është provuar përtej dyshimit të bazuar mirë se i akuzuari ka kryer veprën penale për të cilën ai akuzohet.

Andaj, kolegji penale i kësaj Gjykate gjen se, gjykata e shkallës së parë ka vepruar drejtë dhe ligjshëm kur të pandehurin Sh.B, në bazë të nenit 363 par.1 nënpar.1.3 të KPP-ës, e ka liruar nga akuza për veprën penale Blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitja e paautorizuar e narkotikëve, substancave psikotrope dhe analoge, nga neni 267 par.2 lidhur me nenin 31 të KPRK-së, ngase nuk ka prova që mund të vërtetojnë se i njëjti ka kryer veprën penale për të cilën është akuzuar.

Nga sa u tha më lartë, e në bazë të nenit 401 të KPRK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS

PAKR.nr.54/24

Datë: 03.04.2024

Bashkëpunëtore profesionale,

Kryetare e kolegjit,

Gresë Latifi

Kadrije Goga Lubishtani

Anëtarët e kolegjit:

Vaton Durguti

Skender Çoçaj
